



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 08/2009

Më 10. 03. 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Zef Morina, Berim Ramosaj, Sala Berisha – Shala dhe Kaqusha Jashari.

Munguan: Slobodan Petroviq dhe Mufëra Şinik.

Pjesëmarrës të tjerë: Ali Hamiti, Theranda Beqiri, Adnan Berisha dhe Muharrem Gaashi - ZRRRE; Arben Gjukaj – KEK; Naim Abdullahu – KOSST; Lumnije Murati – Presidanca; Petrit Zogaj - “FOL 08”; Ramadan Klisurica dhe Driton Selmanaj - KDI.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 03. 03. 2009;
3. Shqyrtimi i nismës për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping;
5. Shqyrtimi i Plani të veprimit;
6. Të ndryshme.

## **I. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetarja** – Propozoi të hiqet nga rendi i ditës pika e katërt (4) Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping, për shkak se Grupi i punës ende nuk e ka përfundua Raportin me amendamente.

Komisioni njëzëri e mbështeti propozimin e kryetares, që pika e katërt (4) të hiqet nga rendi i ditës dhe në vend të saj të vihet pika e pestë (5).

## **II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 03. 03. 2009**

Procesverbali i mbledhjes së 03 marsit 2009 u miratua me vërejtjet e deputetes Safete Hadergjonaj.

## **III. Shqyrtimi i nismës për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike**

**Kryetarja** – Ua dha fjalën përfaqësuesve të ftuar të zyrave përkatëse, si: Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (në vijim ZRRE), Korporatës Energjetike të Kosovës (në vijim KEK) dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (në vijim KOSST).

**Ali Hamiti - ZRRE** - E filloi diskutimin me vlerësimin e çështjes së tarifave, një prej çështjeve më të rëndësishme në sektorin e energjisë. Z. Hamiti, tha se automatikisht kemi thënë jo për rritjen, por fillimisht do të ishte mirë që këtë pikë ta shqyrtojmë një herë tjetër, sepse ende nuk kemi marrë vendim a do të rritet apo sa do te jete rritja e tarifave. Duke shtuar se pas konsultimeve me Bordin e Rregullatorit, që është kompetent për ta bërë një gjë të tillë, do të dihet për vendimin përfundimtar, sepse ky është proces i rregullt që ZRRE-ja për çdo vit ose periudhë e shqyrton ngritjen e tarifave. Jemi dëshmitarë se brenda këtij viti ZRRE-ja i ka shqyrtuar tri herë tarifat. Në pajtim me dispozitat ligjore ZRRE-ja, ka shpallur shqyrtimin e tretë të tarifave dhe i ka ftuar, në këtë rast ndërmarrjet e energjisë KOSTT-in, dhe KEK-un, të aplikojnë për të hyrat e vitit 2009. Njoftoi se të dyja këto ndërmarrje i kanë paraqitur kërkesat e veta paraprake dhe preliminare. Pasi i mori aplikacionet ZRRE-ja doli me një raport konsultativ, që është quajtur dhe është bërë publik. Duke u mbështetur në analiza dhe në parashikime, ZRRE-ja e ka dhënë propozimin për rritje eventuale 2.5%, kundrejt asaj të KEK-ut 9.8%. Si përfundim është bërë një propozim i balancuar kundrejt atij të KEK-ut dhe të KOSTT-it, në mënyrë që tarifat e mbledhura të jenë ndihmesë dhe refleksion për të funksionuar këto dy kompani. Ato janë bazuar në një metodologji të balancuar për tarifat. ZRRE-ja e ka për detyrë ta bëjë atë meqë bazohet në profesionalizëm dhe në paanshmëri.

**Arben Gjokaj - KEK** – Para Komisionit e elaboroi rolin e KEK-ut si ndërmarrje publike që përbën monopolin për prodhimin dhe furnizimin më energji elektrike deri te konsumatori. Shtoi se në strategjinë e KEK-ut ekzistojnë plane edhe objektiva që korporata të jetë e qëndrueshme financiarisht, që një herë e përgjithmonë të mos mbetet barrë e Qeverisë dhe e buxhetit të vendit, në projekte kapitale. Duke u ndalur te tarifat tha se aplikimi i fundit tarifor i KEK-ut në ZRRE i paraqet shumë sinjerisht nevojat e

Korporatës, në të cilën është bërë ky aplikim, në krahasim me nevojat e përmirësimit të ofrimeve të shërbimeve cilësore për konsumatorët që KEK-u të bëhet i qëndrueshëm financiarisht - gjithnjë duke u bazuar në strategjinë kombëtare që e ka KEK-u kundrejt nevojave për zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë elektrike. Po ashtu duke pasur parasysh ndjeshmërinë e konsumatorëve për shtrenjtësimin e tarifave dhe për zbatimin e tyre, ka marrë për bazë probleme dhe vështirësi që mund të paraqiten. Shtoi se çdo përpjekje, për të mos e lejuar rritjen e të hyrave të KEK-ut, do të ishte dështim në zhvillimin e sektorit energjetik. Për ngritjen e tarifave, z. Gjukaj arsyëja kryesore është se Korporata e sheh të arsyeshme se me rritjen e të hyrave rriten qëndrueshmëria dhe performanca para konsumatorëve, meqenëse nga ZRRE-ja është kërkuar një rritje mesatare për të gjitha grupet tarifore 9.8%. Kaq do të jenë nevojat për investime kapitale.

**Naim Abdullahu - KOSTT** – Tha se aplikimi i KOSTT-it është bërë në bazë të nevojës. KOSTT-i është shumë i kufizuar në kërkesat që mund të bëhen dhe të zbatohen nga Rregullatori në baze të legjislacionit në fuqi. Mirëpo ka mundësi që në të ardhmen të ndryshohet metodologjia për zbatimin e tarifave. Kërkesa e KOSTT-it, në aplikacionin drejtuar ZRRE-së për vitin 2009, ka qenë 20 milionë euro, ndërsa janë miratuar vetëm 18 milionë euro. Kjo KOSTT-it i shkaktoi pengesë në proceset e tij, sepse aktualisht zhvillimet kapitale KOSTT-i i realizon me grantet e Qeverisë dhe me donatorë. Sa i përket transmisionit, gjithnjë duke u bazuar në strategji, në qoftë se nuk pranohen kërkesat e dërguara, transmisioni në rigjenerimin e tregut konkurrues, çdo kërkesë për zvogëlim do ta dëmtonte KOSTT-in.

**Fatmir Rexhepi** – Theksoi se sipas diskutimeve të tri kompanive kërkesat e tyre duhet të bazohen në ligj. Shihet se KEK-u ka nxjerrë një balancë me pëlqimin e ZRRE-së dhe të KOSTT-it. Kërkoj që qëndrimet të jenë të balancuara, sepse në fund ZRRE-ja ka dalë me një shifër 2.5% të ngritjes së tarifave. Nuk pajtohet me arsyetimin e KEK-ut që tarifatat të ngrihen sipas shpenzimeve, sepse me shtrenjtësimin e tyre ngarkohet qytetari ose konsumatori i rregullt i pagesës së rrymës. Kjo kërkesë nuk është efektive, sepse ata që nuk paguajnë nuk ngarkohen fare, as nuk sanksionohen. Për ta evituar këtë situatë KEK-u duhet të marrë masa të tjera. Ndër to do të ishte edhe zvogëlimi i shpenzimeve, e jo kërkesa për ngritje të tarifave. Pyeti ZRRE-në: Pse nuk e ka kërkuar zvogëlimin e humbjeve?

**Berim Ramosaj** – Diskutimin e tij për çështjen e ngritjes së tarifave e ndau në tri koncepte. Sipas të parit - kur është bërë korporatizimi i ndërmarrjeve publike është menduar se vetëm me ndërrimin e emrit të këtyre kompanive do të ndryshojnë edhe problemet, por kjo nuk ndodhi; koncepti i dytë - ka të bëjë me dobësitë e menaxhimit të KEK-ut dhe me performancën e dobët me një shkallë shumë të ulët të efikasitetit; në të tretin dhe të fundit, tha se shpenzimet e mëdha që ka KEK-u, janë të panevojshme dhe dallohen nga ato të ndërmarrjeve të tjera të vendit. Edhe ZRRE-ja duhet të jetë më e vëmendshme në këtë drejtim, sepse ka për detyrë t'i harmonizojë kërkesat e qytetarëve dhe kërkesat e KEK-ut, por gjithnjë pa bërë balancime, sepse balancimet nuk janë të mira. Që KEK-u të sigurojë benefit i bëri thirrje ta bëjë një transformim të përgjithshëm me uljen e shpenzimeve dhe me ngritjen e efektivitetit.

**Kaqusha Jashari** – Diskutimin e vet po ashtu e bazoi në tri çështje. E para ishte kërkesa e KOSST-it, për shkak të humbjeve teknike dhe të humbjeve komerciale deri në 22.7% dhe vlerësoi se këto humbje janë pasojë e menaxhimit jo të mirë. Për këtë theksoi se duhet të ketë edhe përkrahje institucionale; E dyta - ka disbalanc ndërmjet eksportit dhe importit dhe kërkoi shpjegim për këtë çështje; E treta – të vlerësohen asetet e KEK-ut. Njëherësh kërkoi nga ZRRE-ja t'i marrë parasysh këto vërejtje dhe shtoi se është kundër rritjes së tarifave.

**Ethem Çeku** - Ishte i mendimit që t'i jepet mbështetje sektorit të energjisë në dobi të furnizimit më të mirë të qytetarëve më energji. Shtoi se KEK-u do të duhej të mbështeste çdo formë të rritjes së inkasimit. Mirëpo nuk ishte i pajtimit që me ngritjen e tarifave të mbulohen shpenzimet kapitale, sepse kjo ndikon në ngritjen edhe të çmimeve të tjera. Me këtë rëndohet situata ekonomike e qytetarëve. Mendon se ZRRE-ja ka qasje më të mirë me shtrenjtësimin e tarifave 2.5% e jo KEK-u me 9.8% për biznes dhe 11% për amvisëri. Kërkoi që si Komision të ushtrohet ndikim në Kuvend dhe të shtrohet në diskutim ndryshimi i Kodit penal, që të sanksionohen vjedhja e rrymës dhe ndërhyrja në njëhsorët e matjes.

**Kryetarja** - Theksoi se raporti konsultativ i ZRRE-së është raport i balancuar. Kërkoi nga KEK-u ta rritë aktivitetin e inkasimit të faturave të energjisë elektrike, në mënyrë që të rritet edhe performanca e tij. Kjo të bëhet jo duke kërkuar zbatimin e tarifave të reja, sepse po të rritej inkasimi dhe po të evitoheshin në përgjithësi vjedhjet dhe humbjet, nuk do të kishte nevojë për tarifa të reja.

**Zef Morina** – Tha se situata energjetike tani është më e mirë se në vitet e mëparshme. Të flitet për ngritje të tarifave nuk është veprim i mirë dhe i përshtatshëm. Njëherësh e ngriti edhe çështjen e pagave në KEK dhe kërkoi sistem të balancuar pagash. I shtroi tri pyetje për të ftuarit: A ka KEK-u strategji si të grumbullohen mjetet? A po punohet në çështjen e humbjeve të energjisë? A do të bëhet kategorizimi social i pagesës?

**Safete Hadergjonaj** – Theksoi se në diskutime për çështje të rëndësishme dhe të ndjeshme duhet të jemi më praktikë e jo teorikë. Shtoi se KEK-u nuk mund ta zgjidhë problemin duke i ngritur tarifën, sepse po të paguhej rryma nuk do të kishte nevojë për ngritje të tarifave. Sa i përket performancës është bërë diçka, por jo aq sa duhet. Në fund përkrahu propozimin e z. Çeku, që të iniciohet çështja e ndryshimit të Kodit penal, sepse në këtë mënyrë do t'i ndihmohej KEK-ut të dalë nga kjo situatë e pafavorshme.

**Sala Berisha - Shala** – Afati ligjor për paraqitjen e komenteve është deri më 13 mars 2009, ndërsa Kuvendi ka seancë më 12 mars 2009, prandaj nuk ka mundësi të bëhet rekomandim nga Komisioni. Se a mund të shtyhet kjo datë, mbetet të shihet a e lejon ligji. Borxhet e mëdha nuk duhet të ndikojnë në ngritjen e tarifave. Pyeti: A është e vërtetë se në janar janë “fryrë” faturat e energjisë elektrike?

**Ali Hamiti - ZRRE** – Duke iu përgjigjur në mënyrë të përgjithësuar të gjitha vërejtjeve dhe pyetjeve, tha: Ka asete të paktizuara nga viti 2008; importi është i lejuar, sepse çmimi i energjisë elektrike është specifik, nuk është si produktet e tjera, sepse ndryshon

orë për orë; ka reduktime të personelit në KEK; humbjet janë të paevitueshme; rritja e tarifave është absolutisht e vogël; borxhet e vjetra janë çështje të Qeverisë; kategorizimi i klientëve nuk mund të bëhet; në fund tha se nuk është e mundur të kërkoet energji cilësore pa i ngritur tarifat.

**Arben Gjukaj - KEK** – Duke iu përgjigjur pyetjeve dhe vërejtjeve në përgjithësi, tha: Nuk qëndron fakti se janë fryrë faturat. Ka qenë muaji janar që është më i ftohti, pastaj disa konsumatorë e kanë mbajtur derën të mbyllur për një kohë të gjatë. Po ashtu rryma elektrike nuk është shfrytëzuar racionalist. KEK-u nuk eksporton rrymë, por plason rrymë dhe atë prej orës 00:00 deri në orën 06:00, ndërkaq importohet nga ora 06:00 deri në orën 23:00. Theksoi se humbjet janë sfidë për vetë KEK-un. Shtoi se janë duke punuar në inkasim. Në shkurt janë inkasuar më se 15 milionë euro. Propozimi i ZRRE-së për ngritje të tarifave vetëm për 2.5% është i papranueshëm, duke marrë parasysh planifikimet dhe gjendjen që ekziston në terren. E ftoi Komisionin ta vizitojë KEK-un që të shihet në çfarë kushtesh punohet.

**Naim Abdullahu - KOSST** – Duke iu përgjigjur të gjitha vërejtjeve dhe pyetjeve në mënyrë të përgjithësuar, tha: Vlerësimi i aseteve nga ana e ZRRE-së, krijon probleme edhe te KOSST-i dhe te KEK-u. Kërkesat e KOSST-it nuk janë marrë parasysh, sepse janë kërkuar 100 milionë euro, ndërsa janë aprovuar 40 milionë euro. Kërkoi nga Komisioni të merren parasysh kërkesat për vlerësimin e aseteve, në mënyrë që kërkesat e KOSST-it të jenë më reale.

**Kryetarja** – Ia dha fjalën edhe përfaqësuesit të Komisionit AD-HOC të shoqërisë civile për t'i paraqitur vërejtjet e tyre kundër ngritjes së tarifave të energjisë elektrike.

**Petrit Zogaj - "FOL 08"** – Theksoi se problemi kryesor i KEK-ut është menaxhmenti i tij, jo mjetet financiare, sepse pa një plan afatmesëm dhe pa një plan afatgjatë, kërkesa e ngritjes së tarifave, nuk është reale. Kërkoi që Komisioni ta ketë parasysh petitionin e Komisionit të shoqërisë civile të nënshkruar nga qytetarët e Kosovës, sepse edhe KEK-u është i disponuar të pranohet kërkesa e ZRRE-së për 2.5%.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

### **Përfundim**

- I. ZRRE-ja është autoritet i vetëm kompetent dhe i pavarur, sipas Ligjit, për caktimin e tarifave të energjisë elektrike;
- II. Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Kosovës, Komisioni nuk mbështet kërkesën e KEK-ut dhe të KOSTT-it për ngritjen e tarifave për këtë periudhë.

Lidhur me këtë Kuvendit të Kosovës i dërgohet ky

#### Rekomandim

- I. Të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës ta shqyrtojë situatën e përgjithshme të furnizimit me energji dhe të ndërmarrë veprime përkatëse për mbështetje të gjithanshme institucionale, me qëllim të përmirësimit të performancës së KEK-ut dhe të sigurimit të furnizimit më cilësor me energji elektrike.

#### IV. Shqyrtimi i Planit të veprimit

**Kryetarja** – Për shqyrtimin e Planit të veprimit të Komisionin kërkoi të formohet një grup pune.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni nxori këtë

#### Përfundim

- I. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Planit të veprimit të Komisionit me këtë përbërje: Myzejene Selmani, Safete Hadergjonaj dhe Haki Shatri.

#### V. Të ndryshme

##### a) Çështje vijuese

**Haki Shatri** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se në mbledhjen e radhës do ta sjellë Raportin me amendamente të Projektligjit për zonat ekonomike.

**Zef Morina** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se më 16.03.2009, Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për rrugët ta vizitojë Komunën e Mitrovicës dhe t'i ftojë të gjithë anëtarët e Komisionit të marrin pjesë.

**Kryetarja** – I njoftoi anëtarët e Komisionit se ka ardhur një ftesë nga Parlamenti i Austrisë për të vizituar këtë vend. Për agjendën e vizitës sa më parë do të njoftoheni zyrtarisht.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 00.

Kryetare e Komisionit

---

Myzejene Selmani